

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	PD: Qeveria të ndërhyjë në uljen e çmimit të naftës, të eliminohet taksa e qarkullimit
ADRESA	https://kohajone.com/aktualitet/pd-qeveria-te-nderhyje-ne-uljen-e-cmimit-te-naftes-te-eliminohet-taksa-e-qarkullimit/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 08:55:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 08:54:47 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	523d1ded99f0509bd2038145cd5073e4ccfb14f6206699f397daa7046369f479
TEKSTI	20d943f5af4f87f85a4446bd9272546eecdeabc48be4bab146b0d355dc9dda60
PAMJA	e872395f72f744d6806bf18e0525df1a722a692f726d81ec6d0f8885653fc05d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d078f10928c14b46d811df54ff793d9ed9546e7bb4f07a3bbf8917dc4c24ea1b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	908b1c27d6fb4398f588aae15509a84ac3468307df4d4ded5fae648af40858f1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d078f10928c14b46d811df54ff793d9ed9546e7bb4f07a3bbf8917dc4c24ea1b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


PD: Qeveria të ndërhyjë në uljen e çmimit të naftës, të eliminohet taksa e qarkullimit

AKTUALITET EKONOMI LAJME E MARTË, 15 SHTATOR 2026 10:54



Partia Demokratike denoncon rritjen e çmimit të naftës në Shqipëri dhe i kërkon qeverisë të ndërhyjë menjëherë përmes lehtësive fiskale.

Deputeti i PD-së, Eno Bozdo, e cilësoi situatën si emergjente, duke argumentuar se çmimi i naftës ka arritur në nivele rekord dhe po rëndon si ekonomitë familjare, ashtu edhe bizneset dhe sektorin prodhues.



Deklarata e Bozdos:



Këto ditë, çmimi i dizelit/karburantit në Shqipëri ka arritur nivele rekord, të papërbalueshme për ekonominë tonë familjare por edhe atë prodhuese, duke u tregtuar me rreth 229 lekë për Litër, ose ndryshe rreth 2,5 euro për litër.

Ky nivel e vendos Shqipërinë:

Si vendin me çmimin më të lartë të dizelit në rajon, rreth 30% mbi mesataren rajonale;
Mbi mesataren e Bashkimit Evropian, ku çmimi mesatar i dizelit ishte 2 €/L (më 7 shtator 2026)
Mesatarja botërore: 1,4 euro/L
Mesatarja në BE-27: 2,03 €/L
Sipas të dhënave globale (Global Petrol Prices, Fuel Eide), Shqipëria:

është në grupin e 5 vendeve më të shtrenjta në Evropë për dizel, bashkë me Monakon, Finlandën, Gjermaninë, Holandën dhe Danimarkën.

ka çmim dizeli dukshëm mbi mesataren evropiane dhe rreth 55–60% mbi mesataren botërore

Për krahasim, në të njëjtën periudhë çmimet e dizelit në vendet fqinje janë:

LAJMET KRYESORE



SPAK dhe BKH hetojnë kullat e Tiranës. Kush i financon?



Sot vendimi i Gjykatës së Lartë/Tirana duhet të drejtohet nga kryetari i zgjedhur



Vuçiç largohet nga Presidenca, por synon të rikthehet si Kryeministër i Serbisë



Me 16 shtator parashikohet mbi 1 milionë qytetarë në Prishtinë. Pritet vendimi i Hagës. Ka dyshime për trazira nëse....



Rama për pagat e gjyqtarëve: Askush nuk e zëvendëson Parlamentin, në 17 shtator mbaron episodi i tensionuar

TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spalletit dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

MË TË LEXUARAT

Serbi: rreth 2,00 €/L ose 18% me lire se ne Shqiperi;
Kosovë: rreth 1,76 €/L ose 32% me lire se nje Shqiperi;
Maqedoni e Veriut: rreth 1,6 €/L ose 41% me lire se nje Shqiperi;
Mal i Zi: rreth 1,87 €/L ose 20% me lire se nje Shqiperi;
Bosnjë-Hercegovinë: rreth 1,7 €/L ose 27% me lire se nje Shqiperi;

Arseyeja kryesore sot e çmimeve kaq të larta të dieselit në Shqipëri është ngarkesa shumë e lartë fiskale: shqiptarët paguajnë taksa afërsisht dyfishin e rajonit, dhe nuk marrin në këmbim atë që meritojnë!

Në çmimin final të dizelit në Shqipëri, ngarkesa fiskale përbën rreth 53% (afërsisht 1,00–1,16 €/L taksa për litër), përfshirë:

akcizën fikse (~0,41 €/L),

taksën e qarkullimit,

taksën e karbonit, dhe

TVSH-në 20% që aplikohet mbi çmimin total, pra edhe mbi taksat e tjera.

Në vendet e rajonit, barra fiskale mbi dizelin është dukshëm më e ulët, zakonisht rreth 35% e çmimit final. Kjo do të thotë se, për të njëjtin çmim ndërkombëtar të naftës, qytetarët dhe bizneset në Shqipëri paguajnë taksa afërsisht dyfishin e rajonit për litër dizel.

Ajo që e veçon Shqipërinë përsëri, në dallim me vendet e tjera të rajonit dhe të BE-së, është mungesa totale e masave lehtësuese, ndërsa të gjitha vendet e rajonit kanë vepruar me ndërhyrje fiskale lehtësuese:

Serbia ka ulur përkohësisht akcizat mbi benzinën dhe diezelin,

Maqedonia e Veriut ka ulur TVSH-në për karburantet nga 18% në 10%, për të zbutur ndikimin e çmimeve të larta.

Kosova, Mali i Zi dhe Bosnja kanë përdorur në periudha të mëparshme ulje akcizash dhe kufizime marzhesh, duke mbajtur çmimet më të ulëta se në Shqipëri.

Nuk mund të mos përmendim këtu edhe në argument tjetër: ndërsa çmimet e dieselit rriten, ndërsa qytetarët paguajnë më shtrenjtë nga xhepi i tyre, qeveria fryhet. Nga kriza e mëparshme e naftës, qeveria shqiptare arkëtoi rreth 15 milionë euro më shumë në xhepat e saj, në mënyrë të pamerituar. Asnjë qeveri normale nuk i mban këto para, por gjen mekanizmat për t'ia kthyer ato ekonomisë dhe familjeve. Sepse asnjë qeveri e përgjegjshme nuk pranon të majmet, kur popullata e saj varfërohet!

Të nderuar qytetarë,

Përballë kësaj situatë të paprecedentë, që nuk dihet se si dhe se kur do të zgjidhet, dhe që realisht ka tronditur tregjet në të gjithë vendet, të gjitha qeveritë në botë kanë zgjedhur një apo disa mekanizma lehtësimi të cilat i aplikojnë mbi strukturën/ngarkesën fiskale të çmimit të dieselit, për të lehtësuar, me aq sa kanë mundësi, çmimin e lartë të dieselit i cili, ka ndikim jo vetëm në ekonominë familjare të secilit prej nesh, por mbi të gjitha në ekonominë prodhuese dhe atë të shërbimeve.

Për këtë qëllim, Partia Demokratike i kërkon me këmbëngulje qeverisë të lehtësojë menjëherë ngarkesën fiskale mbi karburantet. Në veçanti, ne i qëndrojmë propozimit tonë të eliminimit të taksës mbi qarkullimi dhe uljes së përkohëshme të akcizës, kombinim ky që do ta sillte çmimin e dieselit në Shqipëri në mesataren e rajonit.

Më duhet të rikujtoj këtu se cdo iniciativë ligjore e Partisë Demokratike për një propozim të tillë, është rrëzuar me votat e Partisë Socialiste në Kuvend!

Cdo refuzim i mëtejshëm i këtyre nismave si dhe cdo këmbëngulje në pozicionin e papërgjegjshmërisë, do të sjellë pasojë shumë të rënda për të gjithë.

ETIKETA CMIMI PD TAKSA E NAFTES

MË SHUMË NGA AKTUALITETI



Gjendet një automjet i djegur në zonën e Cerkovinës, dyshohet se është...

GJKKO shpall vendimin për "Revanshin", Durim Bami dënohet...

Edmond Ahmeti emërohet Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së





Revista franceze: Nga Thethi në Sarandë, 9 mrekullitë e Shqipërisë që...



Rruga e re e Komanit (video)



Moti sot, 15 shtator 2026: Diell dhe temperatura deri në 31 gradë

LAJMET E FUNDIT



Mbappe dhe Dembele përplasen para ceremonisë së “Topit të Artë”

[18 MINUTA MË PARË](#)



Klopp nis epokën e re te Gjermania, lista e parë mund të shkojë deri në 40 lojtarë

[38 MINUTA MË PARË](#)

Gjendet një automjet i djegur në zonën e Cerkovinës, dyshohet se është vjedhur kohë më parë për veprimtari të paligjshme

[37 MINUTA MË PARË](#)

UEFA Nations League/ Biletat për ndeshjet e Kombëtares, tashmë edhe fizikisht pranë “Air Albania”

[56 MINUTA MË PARË](#)

GJKKO shpall vendimin për “Revanshin”, Durim Bami dënohet me 10 vite e 8 muaj burg

[57 MINUTA MË PARË](#)

SPAK dhe BKH hetojnë kullat e Tiranës. Kush i financon?

[1 ORË E 2 MINUTA MË PARË](#)

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Gazeta “KOHA JONË” themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga “Samë Frasheri”, Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: **Nikoll LESI**

KRYEREDAKTOR: **Daniel MUÇAKU**

ZV/KRYEREDAKTOR: **Redjon SHTYLLA**

BORDI: **Elsa KAMBERI, KRYETARE**

NIPT: **J71425013C**



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



© 2024 KOHA JONË. All rights reserved.

[PRIVACY POLICY](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.